



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.08

Prishtinë, më 8.6.2021, në orën 8:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Ardian Gola, kryetar, Enis Kervan, Fitim Uka, Albena Reshitaj, Arijeta Rexhepi, Jahja Kokaj, Memli Krasniqi, Eliza Hoxha, Vlora Dumoshi dhe Jasmina Dediq, anëtarë.

Mungoi: Adriana Matoshi.

Përfaqësues të tjerë: mediat e Kuvendit.

Stafi mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri, Shaip Goxhuli, Diellza Halimi asistente dhe Donjeta Jashari-praktikante.

Mbledhjen e kryesoi Ardian Gola, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Intervistimi i kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

Ardian Gola tha se pas procesit të rishikimit të aplikacioneve të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore janë gjithësejt 27 kandidatë që i kanë plotësuar kriteret e konkursit të njëjtit janë ftuar për intervistim dhe e kanë konfirmuar edhe pjesëmarrjen në intervistë.

Anëtarët e Komisionit u pajtuan që pas procesit të intervistimit dhe vlerësimit të kandidatëve, të procedohet për seancë plenare rekomandimi për emërimin e shtatë anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

Komisioni filloi me intervistimin e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore sipas numrit rendor që kanë aplikuar. Koha e përcaktuar për intervistim për secilin kandidat është caktuar nga dhjetë minuta.

Komisioni pas përfundimit të intervistimit të kandidatëve, vendosi që në mbledhjen e radhës të bëhet përzgjedhja e shtatë kandidatëve bazuar në renditjen e kandidatëve sipas pikëve të marra gjatë intervistimit, përgatitjes së tyre profesionale, si dhe nga përvoja e punës në fushën e trashëgimisë kulturore.

Mbledhja përfundoi në orën 17:00.

E përgatiti:
Stafi mbështetës i komisionit

Ardian Gola

Kryetar i Komisionit